



KOLEGJI - COLLEGE  
**PJETËR BUDI**  
PRISHTINË - PRISHTINA

## **IMPAKTI I SOVRANITETIT, KONSIDERATAT LIDHUR ME TË DREJTAT E NJERIUT DHE MOS-NDËRHYRJEN MBI DEBATIN LIDHUR ME NDËRHYRJEN HUMANITARE**

**MND. Emira Kazazi**

Albtelecom, Albania,

[emirakazazi@yahoo.com](mailto:emirakazazi@yahoo.com)

**Dr. Ervis Çela,**

Lecturer, faculty of Law, University of Tirana, Albania,

[erviscela@hotmail.com](mailto:erviscela@hotmail.com)

### **Abstrakt:**

Koncepti i ndërhyrjes humanitare nga një shtet i jashtëm ka të bëjë me ndërhyrjen që shfaqet për qëllime të mbrojtjes së qytetarëve të shtetit në objektiv, si edhe ato të shtetit (shteteve) ndërhyrëse dhe shteti (shteteve) të treta, të cilat mund të jenë të ekspozuara ndaj masakrave, brutalitetit, persekutimeve fetare apo racore dhe kur këto akte janë të kësaj lloji natyre që shokojnë ndërgjegjen e njeriut. Ne raste të tilla, mund të argumentohet se e drejta për ndërhyrje është ligjërishit dhe moralisht e justifikueshme. Gjithsesi, një ndërhyrje e tillë, ndonëse ka për qëllim forcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, duhet parë nën dritën e parimeve tradicionale të sovranitetit dhe të mos-ndërhyrjes.

Keto parime të përgjithshme janë përfshirë në Kartën e Kombeve të Bashkuara. Parimi i barazisë së sovranitetit krijon thelbin e të gjithë organit të marrëdhënieve ndërkombëtare nën Kartën e Kombeve të Bashkuara. Në mënyrë argumentuese mund të themi që ndërhyrjet humanitare luftojnë kundër parimit të mos-ndërhyrjes siç thuhet në Nenin 2(7) të Kartës së Kombeve të Bashkuara, parimi i mos përdorimit të forcës në Nenin 2(4) dhe gjithashtu bie ndesh me parimin e sovrenitetit të shtetit. Ekziston gjithmonë tension midis këtyre koncepteve. Pajtimi midis parimit të mos-ndërhyrjes, parimit të sovranitetit të shtetit dhe ndërhyrjes humanitare është problematik.

Në këtë kapitull, do të theksoj kuptimin e secilit nocion dhe marrëdhëniet midis këtyre koncepteve dhe doktrinës së ndërhyrjes humanitare. Në pjesën e dytë, do të shqyrtoj përkufizimin e sovranitetit dhe origjinën e saj. Në këtë artikull, do të shqyrtoj konceptin e juridiksionit vendor dhe mos-ndërhyrjen nën ligjin e zakonshëm ndërkombëtar dhe nën Kartën e Kombeve të Bashkuara. Në këtë artikull do të shqyrtoj gjithashtu edhe përkufizimin e konceptit të ndërhyrjes humanitare si edhe konceptit të së drejtës së njeriut dhe cilat të drejta duhet të

merren parasysh për qëllimin e ndërhyrjes humanitare. Në këtë artikull, do të adresoj çështjen nëse ndërhyrja humanitare unilaterale mund të konsiderohet si një përjashtim për ndalimin e përdorimit të forcës nën Nenin 2(4), apo me fjalë të tjera, nëse një veprim i tillë lejohet nga ligji nderkombëtar dhe ndaj për rrjedhim do të ishte në përputhje me rregullin ligjor aktual nderkombëtar. Gjithashtu do të shoh argumentin e "frikës së abuzimit" dhe dështimin e Kombeve të Bashkuara për të vepruar shpejt për të ndrequr dhunimet e të drejtave të njeriut, ndërhyrjes humanitare dhe kufizimet e saj. Në fund, do të përmbledh përfundimet e këtyre çështjeve.

**Fjale Kyçe:** *Sovraniteti, të drejtat e njeriut, parimi i mos-ndërhyrjes*